



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 28, datë 16.09.2020

PËR NOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, KUVENDIN E REPUBLIKËS, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, TË SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS NË DATËN 28.08.2018 DHE TË RISHPALLUR NË DATËN 21.08.2019

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 229 dhe pikës 2 të nenit 234 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 32 dhe shkronjës “a” të pikës 49 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Kuvendin e Republikës, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe të rishpallur në datën 21.08.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARË

Vitore TUSHA

